



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 54

Tiranë – E martë, 6 prill 2021

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 178, datë 25.3.2021	Për kompensimin e veçantë të familjes së ushtarakut, i cili humbi jetën gjatë kryerjes së detyrës në mision ushtarak jashtë vendit..... 5405
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 193, datë 31.3.2021	Për miratimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjeve të huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim..... 5405
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 194, datë 31.3.2021	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 17, datë 15.1.2020, “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale”, të ndryshuar..... 5409
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 198, datë 3.3.2021	Për përcaktimin e operatorit që kryen funksionet e Operatorit të Energjisë së Rinovueshme..... 5410
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 199, datë 31.3.2021	Për përcaktimin e kushteve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, procedurave për shqyrtimin ose anulimin e licencës, tarifave të kërkesës dhe kuotizacionit vjetor të licencave për veprimtari tregtare të pasurive kulturore..... 5410
Urdhër i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. 35, datë 31.3.2021	Për një ndryshim në urdhrin nr. 187, datë 18.12.2020, “Për miratimin e programit të transparencës të rishikuar”, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale..... 5420
Urdhër i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. 36, datë 31.3.2021	Për një ndryshim në urdhrin nr. 188, datë 18.12.2020, “Për miratimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve të rishikuar”, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale..... 5420





**VENDIM**  
**Nr. 178, datë 25.3.2021**

**PËR KOMPENSIMIN E VEÇANTË TË  
 FAMILJES SË USHTARAKUT, I CILI  
 HUMBI JETËN GJATË KRYERJES SË  
 DETYRËS NË MISION USHTARAK  
 JASHTË VENDIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 2, të nenit 28, të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004, “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kompensimin e veçantë të familjes së ushtarakut, major Xhevair Lefter Jazaj, i cili humbi jetën gjatë kryerjes së detyrës në mision ushtarak jashtë vendit, në masën 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

2. Fondi i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përballohet nga buxheti i vitit 2021, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes, në programin buxhetor “Forca e luftimit”.

3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Erion Braçe**

**VENDIM**  
**Nr. 193, datë 31.3.2021**

**PËR MIRATIMIN E  
 LETËRMARRËVESHJES NDRYSHUESE  
 TË MARRËVESHJEVE TË HUAS  
 NDËRMJET REPUBLIKËS SË  
 SHQIPËRISË DHE BANKËS  
 NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM  
 DHE ZHVILLIM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për

marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjeve të huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, sipas tekstit dhe listës nr.1, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Erion Braçe**

*Logo* **BANKA BOTËRORE**  
**BNRZH – IDA GRUPI I BANKËS BOTËRORE**

ZYRA E GRUPIT TË BANKËS BOTËRORE  
 Praterstrasse 31/21  
 Vienna, Austria, 1020

LINDA VAN GELDER  
 Drejtore rajonale, Ballkani Perëndimor  
 Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore

6 gusht 2020

SH.S.ZNJ. Anila Denaj  
 Ministre  
 Ministria e Financave dhe Ekonomisë  
 Blv. “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë

E/i nderuar Zonjë/ Zotëri,

***Amendim i Marrëveshjeve të Huas***

U referohemi marrëveshjeve të huas të lidhura ndërmjet Republikës së Shqipërisë (“Huamarrësi”) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka”) për Huat e renditura në shtojcën 1 të kësaj shkrese (“Marrëveshjet e Huas”). Gjithashtu, i referohemi shkresës së datës 6 gusht 2020, ku jepen shpjegimet e arsyeshme për ndryshimet e kërkuara.

Në lidhje me planifikimin e tranzicionit të LIBOR-it dhe synimin e Bankës për të ruajtur përputhshmërisë ndërmjet kostove të saj të financimit dhe huamarrjes, me anë të kësaj shkrese konfirmojmë miratimin e Bankës për të



ndryshuar dispozitat përkatëse të çdo Marrëveshjeje Huaje për Huat e përmendura në shtojcën 1 të kësaj shkrese, në mënyrë që të ndryshohen kushtet e përgjithshme dhe Marrëveshjet e Huas të zbatueshme për këto Hua, të parashikuara në shtojcën 2 të kësaj shkrese. Gjithashtu, Banka dhe Huamarrësi synojnë të zbatojnë ndryshime të barasvlershme për të gjitha Marrëveshjet e Huas që mund të kenë LIBOR-in ose EURIBOR-in si normën referuese të zbatueshme për interesin, sipas Huas. Si rrjedhojë, nëse një Hua e tillë nuk përmendet në shtojcën 1, Marrëveshja përkatëse e Huas do të çmohet e ndryshuar me anë të këtij amendimi.

Në funksion të drejtësisë, transparencës dhe qëndrueshmërisë, ofrojmë të njëjtat kushte për të gjithë huamarrësit për të gjitha huat e Bankës. Jo të gjitha kushtet do të jenë të përshtatshme për të gjithë huamarrësit. Megjithatë, nënshkrimi i këtij propozimi do të sigurojë se të gjithë huat tuaja do të ndryshohen për të ruajtur marrëveshjen tuaj ekonomike me Bankën gjatë të gjithë kohëzgjatjes së këtyre huave.

Tel.: +43 (1) 2170 782

Faks: +43 (1) 2170 701

Ju lutem, konfirmoni pëlqimin tuaj për sa më lart, duke nënshkruar, vendosur datën dhe duke na kthyer kopjen bashkëlidhur kësaj shkrese. Ky

amendim do të hyjë në fuqi pas: i) marrjes nga Banka të një origjinali të nënshkruar të këtij dokumenti amendimi; dhe ii) marrjes nga Banka të njoftimit të përfundimit të procedurave të brendshme sipas ligjeve të Huamarrësit.

Me respekt,  
(nënshkrimi)

Linda Van Gelder

Drejtoresha rajonale, Ballkani Perëndimor,  
Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore

RËNË DAKORD:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga: Anila Denaj

Funksioni: Ministër i Financave dhe i Ekonomisë

Data: 16.2.2021

dijeninë vëmendje të:

Znj. Adela Xhemali, Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Znj. Majlinda Dhuka, Zëvendëssekretare e Përgjithshme dhe Drejtoresha e Përgjithshme e Departamentit për Zhvillim dhe Qeverisjes së Mirë

Z. Patrizio Pagano, Drejtor Ekzekutiv, Banka Botërore

#### SHTOJCË 1

#### LISTA E HUAVE SIPAS EMRIT DHE NUMRIT TË PROJEKTIT

Numri i Huas	Emri i Projektit	Monedha e angazhimit	Shuma fillestare e principalit	Data e nënshkrimit të Marrëveshjes	Lloji i indeksit
4841	Projekti për Reformimin e Mjedisit të Biznesit dhe Forcimit Institucional	EURO	4,400,000	27-nëntor-2006	LIBOR
4850	Projekti për Transportin	EURO	15,300,000	21-mars-2007	LIBOR
4851	Projekti për Administrimin dhe Menaxhimin e Tokës	EURO	15,200,000	21-mars-2007	LIBOR
7563	Projekti për Zbatimin dhe Adaptimin ndaj Riskut të Katastrofave	EURO	2,000,000	2-korrik-2008	LIBOR
7690	Financim Shtesë për Projektin për Shërbimet Sociale	USD	5,000,000	7-prill-2009	LIBOR
8060	Hua për Politikën e Zhvillimit të Reformës së Sektorit Social	EURO	18,100,000	20-qershor-2011	EUROBOR
8111	Financim Shtesë për Projektin për Sigurinë e Digave	EURO	15,500,000	17-shkurt-2012	EUROBOR
8141	Projekti për Modernizimin e Ndihmës Sociale	EURO	38,000,000	6-qershor-2012	EUROBOR
8211	Projekti për Burimet e Ujit dhe Kullimin	EURO	31,000,000	14-dhjetor-2012	EUROBOR
8323	Projekti për Investimin në Sektorin e Ujit	EURO	62,500,000	16-janar-2014	EUROBOR
8373	Hua për Politikën e Zhvillimit të Modernizimit të Sektorit Financiar	EURO	72,600,000	30-maj-2014	EUROBOR
8399	Hua për Politikën e Zhvillimit të Financimit të Parë Publik	EURO	87,000,000	30-maj-2014	EUROBOR
8401	Projekti për Shërbimet në Mjedis	EURO	7,300,000	25-korrik-2014	EUROBOR
8429	Projekti për Rinovimin e Energjisë në Shqipëri	EURO	112,100,000	3-nëntor-2014	EUROBOR



8466	Projekti për Përmirësimin e Sistemit Shëndetësor	EURO	32,100,000	24-mars-2015	EUROBOR
8489	Projekti për Sigurinë dhe Mirëmbajtjen e Rrugëve bazuar në Rezultate	EURO	65,900,000	10-prill-2015	EUROBOR
8521	Projekti i Ofrimit të Shërbimit për Qytetarët	EURO	29,300,000	23-shtator-2015	EUROBOR
8656	Projekti për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmit	EURO	63,800,000	13-dhjetor-2016	EUROBOR
8689	Hua për Politikën e Zhvillimit të Konkurrencës	EURO	65,800,000	10-shkurt-2017	EUROBOR
8698	Hua për Politikën e Zhvillimit të Sektorit Financiar	USD	100,000,000	20-mars-2017	LIBOR
8817	Financim Shtesë për Projektin e Burimeve të Ujit dhe Kullimit	EURO	23,000,000	19-mars-2018	EUROBOR
8841	Financim Shtesë për Projektin për Modernizimin e Ndhmës Sociale	USD	11,000,000	5-qershor-2018	LIBOR
8850	Projekti Rajonal dhe i Lidhjes së Rrugëve Lokale	USD	50,000,000	5-qershor-2018	LIBOR
8862	Financim i Dytë Shtesë për Projektin për Sigurinë e Digave	EURO	12,000,000	21-qershor-2018	EUROBOR
8933	Projekti për Lehtësimin e Tregtisë në Ballkanin Perëndimor dhe Transportin duke përdorur Qasjen në shumë faza programatike	EURO	17,600,000	19-qershor-2019	EUROBOR

### *Amendim i Marrëveshjeve të Huas*

#### SHTOJCË II NDRYSHIME TË KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME TË ZBATUESHME PËR HUAT

1. Neni III, seksioni 3.02<sup>1</sup>, paragrafi “c” ndryshohet si më poshtë:

“(c) Nëse interesi mbi ndonjë shumë të Huas bazohet në LIBOR dhe EURIBOR dhe Banka vendos që: i) kjo normë reference është ndaluar në mënyrë të përhershme të kuotohet për monedhën përkatëse; ose ii) Banka nuk mundet më, ose për Bankën nuk është më e pranueshme nga pikëpamja tregtare që të vazhdojë të përdorë një normë të tillë reference, në kuadër të menaxhimit të aktiveve dhe pasiveve së saj, Banka do të zbatojë normë tjetër reference për monedhën përkatëse, duke përfshirë ndonjë shpërndarje të zbatueshme që mund të vendosë në mënyrë të arsyeshme. Banka njofton menjëherë Palët e Huas mbi këtë normë tjetër dhe amendimet përkatëse të dispozitave të Marrëveshjeve të Huas, të cilat hyjnë në fuqi në datën e këtij njoftimi. Në ushtrimin e këtij autoriteti, Banka do të veprojë vetëm për të mbajtur dhe ruajtur marrëdhënien që ka ekzistuar më parë ndërmjet kostove të saj të huamarrjes

<sup>1</sup> E zbatueshme për huat që rregullohen nga kushtet e përgjithshme të periudhave pas vitit 2010 (kushtet e përgjithshme për huat, datë 32 korrik 2010; kushtet e përgjithshme për huat, datë 12 mars 2012; kushtet e përgjithshme për financimin e BNRZH-së: financimi i projektit të investimit (2017); kushtet e përgjithshme për financimin e BNRZH-së: financimi i politikës së zhvillimit (2017); kushtet e përgjithshme për financimin e BNRZH: programi për rezultatet (2017).

dhe normave të saj të huadhënies, dhe nuk do të kërkojë për vete ndonjë avantazh tregtar.”

2. <sup>2</sup> Neni III, seksionet 3.02 ose 3.03, të zbatueshme, ndryshohen duke shtuar një paragraf të ri në përputhje me renditjen e zbatueshme të numërtimit, si më poshtë:

“(–) Nëse Banka vendos që: i) LIBOR-i është ndaluar në mënyrë të përhershme të kuotohet për monedhën përkatëse; ose ii) Banka nuk mundet më ose për Bankën nuk është më e pranueshme nga ana komerciale të vazhdojë të përdorë LIBOR-in, në kuadër të menaxhimit të aktiveve dhe pasiveve së saj, Banka do të zbatojë normë tjetër reference për monedhën përkatëse, duke përfshirë ndonjë shpërndarje të zbatueshme që mund të vendosë në mënyrë të arsyeshme. Banka njofton menjëherë Huamarrësin ose Garantuesin mbi këtë normë tjetër dhe amendimet përkatëse të dispozitave të marrëveshjeve të huas, të cilat hyjnë në fuqi në datën e këtij njoftimi. Në ushtrimin e këtij autoriteti, Banka do të veprojë vetëm për të mbajtur dhe ruajtur marrëdhënien që ka ekzistuar më parë ndërmjet kostove të saj të huamarrjes dhe normave të saj të huadhënies, dhe nuk do të kërkojë për vete ndonjë avantazh tregtar.”

3. <sup>3</sup> Nënparagrafi (c) në termin e përkufizuar “Norma e referencës” në shtojcë, e zbatueshme, ndryshohet si më poshtë:

<sup>2</sup> E zbatueshme për huat që rregullohen nga kushtet e përgjithshme që përfshinin termin e përkufizuar “LIBOR” (kushtet e përgjithshme të zbatueshme për huat dhe marrëveshjet e garancisë për huat e shpërndara fikse, datë 1 shtator 1999 (gjithashtu, versioni i ndryshuar në datën 1 maj 2004); kushtet e përgjithshme për huat, datë 1 korrik 2005 (gjithashtu, versioni i ndryshuar më 17 tetor 2007 dhe 12 shkurt 2008).

<sup>3</sup> E zbatueshme për huat që rregullohen nga kushtet e përgjithshme që përfshinin termin e përkufizuar “Norma e



“(c) nëse Banka vendos që: i) LIBOR-i (në lidhje me USD, JPY dhe GBP) ose EURIBOR-i (në lidhje me euron) është nsdalar në mënyrë të përhershme të kuotohet për këtë monedhë; ose ii) Banka nuk mundet më ose për Bankën nuk është më e pranueshme nga pikëpamja tregtare që të vazhdojë të përdorë këtë normë reference, në kuadër të menaxhimit të aktiveve dhe pasiveve së saj, një normë e tillë tjetër reference e krahasueshme për monedhën përkatëse, duke përfshirë çdo shpërndarje të zbatueshme, që Banka do të vendosë në mënyrë të arsyeshme, dhe do të njoftojë Huamarrësin, në zbatim të seksionit 3.02 (c), me kusht që në ushtrimin e këtij autoriteti, Banka do të veprojë vetëm për të mbajtur dhe ruajtur marrëdhënien që ka ekzistuar më parë ndërmjet kostove të saj të huamarrjes dhe normave të saj të huadhënies, dhe nuk do të kërkojë për vete ndonjë avantazh tregtar dhe”

#### Amendimet në Marrëveshjet e Huas<sup>4</sup>

1. Dispozitat përkatëse të marrëveshjeve të caktuara të Huas që përcaktojnë normën e zbatueshme të interesit të Huas, bazuar në LIBOR, ndryshohen duke shtuar një nën-paragraf të ri në përputhje me renditjen e zbatueshme të numërtimit, si më poshtë:

“(--) Nëse Banka vendos që: i) LIBOR-i është ndaluar në mënyrë të përhershme të kuotohet për monedhën përkatëse; ose ii) Banka nuk mundet më ose për Bankën nuk është më e pranueshme nga pikëpamja tregtare që të vazhdojë të përdorë LIBOR, në kuadër të menaxhimit të aktiveve dhe pasiveve së saj, Banka do të zbatojë një normë të tillë reference për monedhën përkatëse, duke përfshirë çdo shpërndarje të zbatueshme që mund të vendosë në mënyrë të arsyeshme. Banka njofton menjëherë Huamarrësin ose Garantuesin mbi këtë normë tjetër dhe amendimet përkatëse të dispozitave të marrëveshjeve të huas, të cilat hyjnë në fuqi në datën e këtij njoftimi. Në ushtrimin e këtij autoriteti, Banka do të veprojë vetëm për të mbajtur dhe ruajtur marrëdhënien që ka ekzistuar më parë ndërmjet kostove të saj të huamarrjes dhe normave të saj të huadhënies, dhe nuk do të kërkojë për vete ndonjë avantazh tregtar.”

---

referencës” (kushtet e përgjithshme për huat, datë 23 korrik 2010; kushtet e përgjithshme për huat, datë 12 mars 2012; kushtet e përgjithshme për financimin BNRZH: financimi i projektit të investimit (2017); kushtet e përgjithshme për financimin BNRZH: financimi i politikës së zhvillimit (2017); kushtet e përgjithshme për financimin BNRZH: programi për rezultatet (2017).

<sup>4</sup> E zbatueshme për huat e monedhës së vetme ligjore që rregullohen nga kushtet e përgjithshme të zbatueshme për huat dhe marrëveshjet e garancisë për huat e monedhës së vetme të datës 30 maj 1995 (gjithashtu edhe versionet e ndryshuara në datat 6 tetor 1999, 2 dhjetor 1997 dhe 1 maj 2004), të cilat i referohen dispozitave përkatëse të interesit në marrëveshjet e huas.



## Lista nr. 1

Projekti për Reformimin e Mjedisit të Biznesit dhe Forcimit Institucional	1.Ligj nr. 9681, datë 6.2.2007
Projekti për Transportin	2.Ligj nr. 9729, datë 10.5.2007
Projekti për Administrimin dhe Menaxhimin e Tokës	3.Ligj nr. 9738, datë 21.5.2007
Projekti për Zbutjen dhe Adaptimin ndaj Riskut të Katastrofave	4.Ligj nr. 9956, datë 17.7.2008
Financim Shtesë për Projektin për Shërbimet Sociale	5.Ligj nr. 10122, datë 11.5.2009
Hua për Politikën e Zhvillimit të Reformës së Sektorit Social	6.Ligj nr. 10443, datë 14.7.2011
Financim Shtesë për Projektin për Sigurinë e Digave	7.Ligj nr. 40/2012, datë 12.4.2012
Projekti për Modernizimin e Ndhmës Sociale	8.Ligj nr. 84/2012, datë 18.9.2012
Projekti për Burimet e Ujit dhe Kullimin	9.Ligj nr. 89/2013, datë 21.2.2013
Projekti për Investimin në Sektorin e Ujit	10.Ligj nr. 34/2014, datë 3.4.2014
Hua për Politikën e Zhvillimit të Modernizimit të Sektorit Financiar	11.Ligj nr. 81/2014, datë 17.7.2014
Hua për Politikën e Zhvillimit të Financimit të Parë Publik	12.Ligj nr. 82/2014, datë 17.7.2014
Projekti për Shërbimet në Mjedis	13.Ligj nr. 151/2014, datë 6.11.2014
Projekti për Rinovimin e Energjisë në Shqipëri	14.Ligj nr. 170/2014, datë 11.12.2014
Projekti për Përmirësimin e Sistemit Shëndetësor	15.Ligj nr. 57/2015, datë 28.5.2015
Projekti për Sigurinë dhe Mirëmbajtjen e Krugëve bazuar në Rezultate	16.Ligj nr. 71/2015, datë 2.7.2015
Projekti i Ofritit të Shërbimit për Qytetarët	17.Ligj nr. 3/2016, datë 28.1.2016
Projekti për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmit	18.Ligj nr. 19/2017, datë 23.2.2017
Hua për Politikën e Zhvillimit të Konkurrencës	19.Ligj nr. 48/2017, datë 13.4.2017
Hua për Politikën e Zhvillimit të Sektorit Financiar	20.Ligj nr. 54/2017, datë 13.4.2017
Financim Shtesë për Projektin e Burimeve të Ujit dhe Kullimin	21.Ligj nr. 31/2018, datë 31.5.2018
Financim Shtesë për Projektin për Modernizimin e Ndhmës Sociale	22.Ligj nr. 53/2018, datë 23.7.2018
Projekti Rajonal dhe i Lidhjes së Krugëve Lokale	23.Ligj nr. 54/2018, datë 23.7.2018
Financim i Dytë Shtesë për Projektin për Sigurinë e Digave	24.Ligj nr. 61/2018, datë 20.9.2018
Projekti për Lehtësimin e Tregtisë në Ballkanin Perëndimor dhe Transportin duke përdorur Qasjen në shumë faza programatike	25.Ligj nr. 62/2019, datë 19.9.2019

## VENDIM

Nr. 194, datë 31.3.2021

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA  
NË VENDIMIN NR. 17, DATË 15.1.2020,  
“PËR PROCEDURAT, KRITERET DHE  
RREGULLAT PËR ZBATIMIN E  
PROGRAMEVE TË NXITJES SË  
PUNËSIMIT NËPËRMJET PUNËSIMIT,  
FORMIMIT NË PUNË DHE  
PRAKTIKAVE PROFESIONALE”,  
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 11, të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 17, datë 15.1.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Shkronja “ë”, e pikës 4, të kreut II, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ë) vendi i punës i financuar nga ky program duhet të vijë si rezultat i shtimit të vendeve të lira të punës në aktivitetin e punëdhënësit.”;

b) Në fund të nënndarjeve “iii” dhe “iv”, të shkronjës “dh”, të pikës 2, të kreut III, shtohen fjalët “... të kompensuar çdo muaj.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR  
Erion Braçe

**VENDIM**

Nr. 198, datë 3.3.2021

**PËR PËRCAKTIMIN E OPERATORIT  
QË KRYEN FUNKSIONET E  
OPERATORIT TË ENERGJISË SË  
RINOVUESHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Përcaktimin e shoqërisë Operatori i Energjisë së Rinovueshme sh.a. si operatori që kryen funksionet e operatorit të energjisë së rinovueshme, sipas parashikimeve të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.

2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

**Erion Braçe****VENDIM**

Nr. 199, datë 31.3.2021

**PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE TË  
POSAÇME TË LICENCIMIT,  
DOKUMENTEVE SHOQËRUESE,  
PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN  
OSE ANULIMIN E LICENCËS,  
TARIFAVE TË KËRKESËS DHE  
KUOTIZACIONIT VJETOR TË  
LICENCAVE PËR VEPRIMTARI  
TREGTARE TË PASURIVE  
KULTURORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 116, pika 3, 117 dhe 118, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

Faqe | 5410

**VENDOSI:****I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Ky vendim përcakton dhe shtrinë fushën e veprimtimit në:

a) licencën për veprimtari tregtare të pasurive kulturore materiale të luajtshme, që përfshihet në kategorinë VI.1 të shtojcës së ligjit për licencat;

b) përcaktimin e kushteve, kriterëve dhe dokumenteve shoqëruese për licencimin e personave fizikë/tregtarë dhe juridikë për veprimtari tregtare të pasurive kulturore materiale të luajtshme;

c) procedurat për shqyrtimin ose anulimin, si dhe për pezullimin e licencës për veprimtari tregtare të pasurive kulturore materiale të luajtshme;

ç) përcaktimin e tarifave të kërkesës dhe tarifave të kuotizacionit vjetor për licencën për veprimtari tregtare të pasurive kulturore materiale të luajtshme.

**II. OBJEKTI DHE SUBJEKTET E  
LICENCËS PËR VEPRIMTARI TREGTARE  
TË PASURIVE KULTURORE MATERIALE  
TË LUAJTSHME**

1. Licenca për veprimtari tregtare të pasurive kulturore materiale të luajtshme është akti administrativ, që i njih titullarit të saj të drejtën të ushtrijë tipin e veprimtarisë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të.

2. Tregtimi i pasurisë kulturore materiale të luajtshme është ushtrimi i veprimtarive tregtare me qëllim:

a) shitjen për publikun;

b) ekspozitën për qëllime tregtare;

c) ndërmjetësimin me qëllim shitjen e pasurive kulturore materiale të luajtshme.

3. Nuk janë objekt tregtimi pasuritë kulturore materiale të cilat konsiderohen të patjetërsueshme, sipas parashikimeve të neneve 106, 107 dhe 108, të ligjit 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

**III. KUSHTET E POSAÇME, KRITERET,  
VLEFSHMËRIA DHE AFATET E LICEN-  
CIMIT**

**A. Kushtet e posaçme dhe kriteret për  
pajisjen me licencë**

1. Personi fizik/tregtari apo personi juridik që kërkon të pajiset me licencë për veprimtari tregtare





të pasurive kulturore materiale të luajtshme duhet të plotësojë kushtet e posaçme, si më poshtë vijon:

a) të deklarojë ambientin ku do të ushtrojë veprimtarinë tregtare, si dhe të garantojë kushtet e sigurisë për ruajtjen e pasurisë kulturore që administron;

b) personi fizik/tregtari apo përfaqësuesi ligjor i personit juridik të ketë kryer arsimin bazë, që është i detyrueshëm në Republikën e Shqipërisë.

2. Përveç kushteve të posaçme, të parashikuara në pikën 1, të kësaj ndarjeje, personi fizik/tregtari apo personi juridik duhet të plotësojë edhe kriteret e mëposhtme:

a) të jetë i regjistruar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi për veprimtarinë tregtare dhe të ketë në objektin e tij të veprimtarisë tregtare e pasurive kulturore materiale;

b) të deklarojë pranë Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (IKRTK) inventarin e objekteve, pasuri kulturore, që ka në administrim;

c) të kryejë pranë IKRTK-së të gjitha procedurat e regjistrimit për objektet që ka në administrim, në zbatim të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”. Çdo objekt pajiset me certifikatën “pasuri kulturore”;

ç) të kryejë pagesën e tarifës për marrjen e licencës pranë IKRTK-së.

3. Subjekti dorëzon kërkesën për pajisjen me licencë, sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi, bashkë me dokumentet shoqëruese që provojnë përmbushjen e kushteve dhe kriterëve të parashikuara në këtë vendim, si dhe dokumentin që provon kryerjen e pagesës së tarifës për marrjen e licencës pranë IKRTK-së.

4. Personi fizik/tregtari ose juridik, si dhe anëtarët e organit administrativ, aksionarit ose ortakut apo personi, që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda personit juridik, nuk duhet të jetë në ndjekje penale ose i dënuar për një vepër penale.

#### **B. Kufizimet e përdorimit të licencës**

1. Licenca nuk lejohet të tjetërsohet apo të trashëgohet nga një subjekt tek tjetri.

2. Në rastet kur licenca është anuluar, subjekti mund të bëjë kërkesë për licencë pasi kanë kaluar të paktën tri vite nga data e anulimit.

#### **C. Vlefshmëria dhe afatet e licencës**

1. Licenca për veprimtari tregtare të pasurive kulturore është pa afat për të gjitha subjektet e licencuara.

2. Licenca është e vlefshme për territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Licenca konsiderohet e anuluar dhe pa ndonjë efekt juridik në rast të vdekjes së personit fizik ose likuidimit të personit juridik.

#### **IV. DOKUMENTACIONI SHOQËRUES PËR PAJISJEN ME LICENCË PËR PERSONIN FIZIK/TREGTARI OSE PERSONIN JURIDIK**

##### **A. Dokumentet shoqëruese për pajisjen me licencë për personin fizik/tregtarin**

Kërkesa për pajisje me licencë për herë të parë për personin fizik/tregtarin, pasi të plotësohen kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë vendim, shoqërohet me:

a) kërkesën për pajisje me licencë, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;

b) kopjen e dokumentit të identifikimit të kërkuarit;

c) certifikatën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit;

ç) vetëdeklarimin mbi gjendjen gjyqësore dhe penale;

d) dokumentin që provon përfundimin e arsimit bazë të detyrueshëm;

dh) dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës për kërkesën për pajisjen me licencë;

e) dokumentin e lëshuar nga IKRTK-ja që vërteton kryerjen e procedurave të regjistrimit në zbatim të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

##### **B. Dokumentet shoqëruese për pajisjen me licencë për personin juridik**

Kërkesa për pajisje me licencë për herë të parë për personin juridik, pasi të plotësohen kriteret dhe kushtet e specifikuar në këtë vendim, shoqërohet me:

a) kërkesën për pajisje me licencë, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;

b) certifikatën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit;

c) kopjen e dokumentit të identifikimit të përfaqësuesit ligjor;

ç) vetëdeklarimin mbi gjendjen gjyqësore dhe penale të anëtarëve të organit administrativ, aksionarit ose ortakut dhe të personit që ka



kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda personit juridik;

d) dokumentin që provon përfundimin e arsimit bazë të detyrueshëm;

dh) dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës për kërkesën për pajisjen me licencë;

e) dokumentin e lëshuar nga IKRTK-ja që vërteton kryerjen e procedurave të regjistrimit në zbatim të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

### **C. Dokumente shoqëruese për pajisje me zëvendësim licence në rast humbjeje ose dëmtimi të ekzistueses**

1. Në rast humbjeje ose dëmtimi të licencës për veprimtari tregtare të pasurive kulturore, subjekti i licencuar paraqet tek IKRTK-ja kërkesën për pajisjen me zëvendësim licence, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Në rastin kur kërkesa ka lidhje me zëvendësimin e licencës së dëmtuar, me qëllim pajisjen me licencë të re, subjekti duhet të dorëzojë licencën ekzistuese të dëmtuar.

3. Në rastin kur kërkesa ka lidhje me humbjen e licencës, me qëllim pajisjen me licencë të re, subjekti, në përgjegjësinë e tij civile dhe penale, dorëzon një deklaratë më shkrim mbi këtë fakt.

4. Licenca e dëmtuar ose e humbur shpallet e pavlefshme dhe lëshohet e re, me të njëjtat të dhëna, por me datë lëshimi të re.

### **V. PROCEDURAT PËR DHËNIEN, PEZULLIMIN OSE ANULIMIN E LICENCËS PËR VEPRIMTARI TREGTARE TË PASURIVE KULTURORE MATERIALE**

#### **A. Dorëzimi dhe pranimi i kërkesave**

1. Kërkesa për licencë, si dhe dokumentet shoqëruese të saj dërgohen nëpërmjet sistemit informatik të integruar për shërbimet e licencimit të veprimtarive tregtare në pasuritë kulturore materiale, që funksionon pranë portalit unik të shërbimeve qeveritare *e-Albania*.

2. Dokumentet për licencë, që ngarkohen në sistem, duhet të jenë:

a) origjinale ose kopje të njësuara me origjinalin;

b) në gjuhën shqipe ose të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes zyrtarë dhe të njësuara me origjinalin;

c) për rastet e dokumenteve të huaja, kopje të vërtetuara nga një autoritet publik i juridiksionit të huaj (zyrtar/noter). Është detyrim të vërtetohet ekzistenca e tyre si zyrtarë apo noterë, nëpërmjet

legalizimit apo apostilimit, sipas ligjeve në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

3. Pagesa e tarifës për përfitimin e licencës kryhet përmes sistemit informatik të integruar për shërbimet e licencimit për veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, që funksionon pranë portalit unik të shërbimeve qeveritare *e-Albania* ose pranë çdo banke të nivelit të dytë, nëpërmjet formularit të faturës për arkëtim.

4. Paraqitja fizike e një apo disa dokumenteve pranë IKRTK-së kryhet vetëm në këto raste:

a) Për dorëzimin e licencës paraardhëse, në rastet e parashikuara në këtë vendim;

b) Kur kërkohet verifikim i dokumentit/dokumenteve nga IKRTK-ja.

### **B. Shqyrtimi i kërkesave lidhur me licencat për veprimtaritë tregtare të pasurive kulturore**

1. Kërkesat për licencim, anulim apo pezullim të licencës, si dhe për pajisje me zëvendësim në rast humbjeje ose dëmtimi të ekzistueses administrohen nga IKRTK-ja.

2. Vendimi për pajisjen me licencë merret nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, me propozim të IKRTK-së.

3. Licenca jepet pas verifikimit të përmbushjes së kushteve dhe kriteve për licencim, të parashikuara në ligjin nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, dhe në këtë vendim. Ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore merr vendim në lidhje me kërkesën për licencë brenda 20 ditësh pune nga regjistrimi i saj.

4. Ndaj vendimit për dhënie ose jo të licencës mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon vendimin.

5. IKRTK-ja bën shpërndarjen e licencave të interesuarve jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga hyrja në fuqi e vendimit të ministrit, nëpërmjet shërbimit postar ose licencat tërhiqen nga vetë subjekti i licencuar apo nga persona të autorizuar me akt noterial për të kryer një veprim të tillë apo persona të autorizuar nga personi juridik. Kopja e autorizimit depozitohet në dosjen që arkivohet.

6. Licenca e miratuar për veprimtaritë tregtare të pasurive kulturore materiale, pajisja me zëvendësim licence në rast humbjeje ose dëmtimi të ekzistueses, si dhe çdo vendim për pezullim ose anulim të licencës regjistrohen në Regjistrin e Licencave për



Veprimtarinë Tregtare të Pasurive Kulturore, i cili administrohet nga IKRTK-ja, si dhe në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

### **C. Tarifa e kërkesës dhe kuotizacioni vjetor i licencave**

1. Tarifa e kërkesës për pajisjen me licencë për herë të parë për zëvendësim licence në rast humbjeje ose dëmtimi të ekzistueses ose për pezullim të licencës është 100 (njëqind) lekë.

2. Kuotizacioni vjetor i licencave është një pagesë periodike që paguhet nga subjekti i licencuar, në vlerën 200 (dyqind) lekë.

3. Përrjashtohet nga pagesa e kuotizacionit vjetor subjekti, licenca e të cilit është pezulluar ose anuluar.

4. Të ardhurat e përfituara sipas pikave 1 dhe 2, të ndarjes C, të këtij kreu, shkojnë në llogari të Fondit Kombëtar të Kujdesit të Trashëgimisë Kulturore Materiale.

### **Ç. Pezullimi dhe anulimi i licencës**

1. Licenca për veprimtari tregtare të pasurive kulturore materiale pezullohet me vendim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, me propozim të IKRTK-së, në rastet e mëposhtme:

a) kur subjekti i licencuar ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit ose ka ndonjë pengesë tjetër ligjore me ushtrimin e funksioneve publike në përputhje me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, për periudhën kohore që ekziston shkaku që ka çuar në pezullim;

b) kur ka filluar një procedurë verifikimi ndaj subjektit të licencuar për shkeljet e parashikuara nga nenet 258 dhe 259, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar;

c) me kërkesë të vetë subjektit të licencuar.

2. Licenca për tregti në pasuritë kulturore materiale anulohet nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore sipas kushteve të parashikuara në nenin 118, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, si dhe në rastin kur individi, mbajtës i licencës, humbet jetën.

3. Procedura e inspektimit, pezullimit dhe anulimit të licencës kryhet, si më poshtë vijon:

a) me kërkesë të IKRTK-së, strukturat kompetente të inspektimit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore ngarkohen me verifikimin e

ligjshmërisë së ushtrimit të aktivitetit të veprimtarisë tregtare të pasurive kulturore;

b) strukturat kompetente të inspektimit kryejnë kontrolle dhe verifikime në mjediset dhe depot e subjekteve të licencuara për veprimtari tregtare të pasurive kulturore me qëllim verifikimin nëse titullari i licencës respekton detyrimet e përcaktuara në këtë vendim;

c) për çdo rast të konstatuar, struktura e inspektimit harton një raport vlerësimi të fakteve dhe ia kalon për shqyrtim IKRTK-së;

ç) në rastin kur ekzistojnë kushtet për pezullimin e licencës, IKRTK-ja ia kalon dosjen ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore me rekomandimin përkatës;

d) në rastin kur ekzistojnë kushtet për anulimin e licencës, IKRTK-ja ia kalon dosjen ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore me rekomandimin përkatës, pasi ka marrë mendim nga KKMPK-ja.

4. Ndaj vendimit për pezullimin e licencës mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

## **VI. DETYRIMET E SUBJEKTTIT TË LICENCUAR**

### **A. Detyrimi mbi pasuritë kulturore në administrim**

Subjekti i licencuar për veprimtari tregtare të pasurive kulturore materiale ka të njëjtat detyrime të përcaktuara në nenin 25, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

### **B. Detyrimi lidhur me prejardhjen dhe origjinalitetin e pasurisë kulturore**

1. Për çdo shitje të një artikulli të pasurisë kulturore, që i përket subjektit të licencuar ose që vihet në shitje nën ndërmjetësimin e tij profesional, ky i fundit duhet t'i sigurojë blerësit një deklaratë sipas modelit bashkëlidhur këtij vendimi, e cila të përmbajë të paktën të dhënat e mëposhtme:

a) identifikimin e pasurisë kulturore;

b) deklarin mbi origjinalitetin artistik apo të prodhimit të deklaruar;

c) autorësinë dhe kohën e krijimit të veprës;

ç) një përshkrim të prejardhjes së identifikuar të pronësisë së tij.

2. Në rastet kur, për shkak të mungesës së informacionit të nevojshëm, nuk është e mundur të sigurohen të dhëna për origjinalitetin artistik ose për prejardhjen e pronësisë, subjekti i licencuar



përfshin në deklaratë informacionin që disponohet nga ana e tij në mirëbesim dhe bazuar në njohuritë profesionale të tij. Një kopje e deklaratës vendoset mbi një kopje fotografike të pasurisë kulturore dhe i bashkëngjitet asaj.

3. Subjekti i licencuar ruan një kopje të deklaratës për të paktën pesë vjet nga data e shitjes së pasurisë kulturore.

### **C. Detyrimi lidhur regjistrin dhe raportimin e veprimtarisë**

1. Titullari i licencës për veprimtari tregtare të pasurive kulturore, për çdo artikull të shitur, mban një regjistër, sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit 116, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

2. Titullari i licencës për veprimtari tregtare të pasurive kulturore raporton pranë IKRTK-së sipas parashikimeve të pikës 6, të nenit 116, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

### **Ç. Detyrime në kuadër të luftës kundër tregtisë së paligjshme**

1. Titullari i licencës për veprimtarinë tregtare të pasurive kulturore informon subjektin, për të cilin ai kryen shërbime përfaqësimi ose ndërmjetësimi në lidhje me detyrimet dhe sanksionet në zbatim të nenit 259, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, për:

a) detyrimet në lidhje me eksportin e përhershëm të pasurisë kulturore nga territori i Republikës së Shqipërisë;

b) detyrimet në lidhje me eksportin e përkohshëm të pasurisë kulturore nga territori i Republikës së Shqipërisë;

c) detyrimet në lidhje me importin e pasurisë kulturore në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ç) detyrimin për të mbajtur certifikatën e prejardhjes dhe origjinalitetit.

2. Në rastet kur tregtarët e pasurive kulturore njoftohen nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore se një vend i huaj kërkon kthimin e një objekti të pasurisë kulturore në posedim të tyre ose për të cilin ata kanë një mandat tregtar, marrin të gjitha masat sipas ligjit për të bashkëpunuar në mirëbesim me ministrinë për kthimin e objektit në vendin e origjinës ose në vendin nga i cili është eksportuar në mënyrë të paligjshme, sipas ligjit, dhe pavarësisht kompensimit të duhur të pronarit sipas ligjit apo detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë.

### **VII. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

1. Të gjitha kërkesat për licencë për veprimtari tregtare të pasurive kulturore materiale bëhen me pagesë, sipas tarifave të përcaktuara në këtë vendim.

2. Të gjitha kërkesat për licencë për veprimtari tregtare të pasurive kulturore materiale dhe dokumentacioni shoqërues dërgohen në formë fizike nëpërmjet shërbimit postar pranë IKRTK-së deri në kalimin e të gjithë procedurës në portalin unik të shërbimeve qeveritare *e-Albania*.

3. Format i licencës miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, me propozim të IKRTK-së.

4. Ngarkohen ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Pasurive Kulturore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
**Erion Braçe**



SHTOJCAT E VENDIMIT PËR KUSHTET E VEÇANTA TË LICENCIMIT,  
DOKUMENTET SHOQËRUESE, PROCEDURAT PËR RISHIKIM OSE  
ANULIM, TARIFAT E KËRKESËS DHE TARIFAT E KUOTAVE VJETORE  
TË LICENCIMIT PËR TREGTI NË PASURINË KULTURORE TË LUAJTSHME

**I. FORMULARI I KËRKESËS**  
**II. MODELI I DEKLARATËS PËR IDENTIFIKIMIN, ORIGINALITETIN DHE**  
**PREJARDHJEN**

**FORMULARI I KËRKESËS PËR LICENCË**  
**Licenca për tregti në pasuri kulturore**

Institucioni përgjegjës: Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore

**1. STATUSI I KËRKUESIT**

- PERSON FIZIK/TREGTAR  
 PERSON JURIDIK

**1.1 STATUSI/ LLOJI I KËRKESËS**

- PAJISJE ME LICENCË PËR HERË TË PARË  
 PAJISJE ME ZËVENDËSIM LICENCE NË RAST HUMBJE (Bashkëlidh një deklaratë personale mbi rrethanat e humbjes së licencës)  
 PAJISJE ME ZËVENDËSIM LICENCE NË RAST DËMTIMI (Bashkëlidh licencën e dëmtuar)

**2. INFORMACIONE SPECIFIKE (në rast se kërkuesi është PERSON FIZIK/TREGTAR)**

SUBJEKTI: Emri \_\_\_\_\_ Mbiemri \_\_\_\_\_

NIPT: \_\_\_\_\_

ID: \_\_\_\_\_

Nr. Tel/Cel: \_\_\_\_\_

Email-i: \_\_\_\_\_

Adresa e kërkuesit: \_\_\_\_\_

Adresa e ushtrimit të veprimtarisë tregtare të pasurisë kulturore: \_\_\_\_\_

**3. INFORMACION SPECIFIK (në rast se kërkuesi është PERSON JURIDIK)**

Emri i SUBJEKTTIT: \_\_\_\_\_

NIPT: \_\_\_\_\_

Administratori: Emri \_\_\_\_\_ Mbiemri \_\_\_\_\_

ID Administratorit: \_\_\_\_\_

Nr. Tel / Cel: \_\_\_\_\_

Email-i: \_\_\_\_\_

Adresa e kërkuesit: \_\_\_\_\_

Adresa e ushtrimit të veprimtarisë tregtare të pasurisë kulturore: \_\_\_\_\_

**4. KLAUZOLA DEKLARATIVE**

*Vetëdeklarim i përgjegjësive për një person fizik/ tregtari*

Unë, i nënshkruari \_\_\_\_\_, në njohje të plotë të pasojave të një deklaratë të pavërtetë, deklaroj se:

- a) të dhënat e deklaruara dhe dokumentet e paraqitura janë të vërteta;  
b) unë nuk kam asnjë çështje të hapur gjyqësore penale dhe nuk jam duke vuajtur një dënim gjyqësor për një veprë penale;  
c) unë i njoh dhe i pranoj kriteret dhe detyrimet për licencën e kërkuar.

*Vetëdeklarim i përgjegjësive për përfaqësuesin e një personi juridik*



Unë, i nënshkruari \_\_\_\_\_, në cilësinë e administratorit të subjektit \_\_\_\_\_, deklaroj se:

- a) të dhënat e deklaruara dhe dokumentet e paraqitura janë të vërteta;
- b) asnjë nga administratorët e Subjektit nuk ka ndonjë çështje penale gjyqësore të hapur dhe nuk jam duke vuajtur një dënim gjyqësor për një vepër penale;
- c) unë i njoh dhe i pranoj kriteret dhe detyrimet për licencën e kërkuar.

#### 5. TË DHËNAT PERSONALE

Unë autorizoj institucionin të përpunojë të dhënat e mia personale (emrin, mbiemrin, numrin e telefonit ose postën elektronike) të mbledhura më sipër, në mënyrë që të ndërmerre sondazhe të automatizuara për të marrë mendimin tim në lidhje me cilësinë e ofrimit të shërbimit.

#### 6. DOKUMENTACIONI I NGARKUAR (*on-line*)

- a) \_\_\_\_\_;
- b) \_\_\_\_\_;
- c) \_\_\_\_\_;

#### 7. DOKUMENTE/ VERIFIKIME/ MIRATIME TË SIGURUARA NGA NDËRVEPRIMI NDËRINSTITUCIONAL

- a) Ekstrakti i regjistrimit të biznesit nga QKB-ja ose vendimi i regjistrimit në gjykatë.

#### 8. BAZA LIGJORE E KËTIJ SHËRBIMI

Ligji nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”

#### 9. NJOFTIM

Marrja e informacionit: \_\_\_ posta; \_\_\_ e-mail; \_\_\_ e-albania; \_\_\_ dorazi

E-mail (për njoftimin): \_\_\_\_\_

Afati i njoftimit: jo më vonë se 10 ditë nga urdhri i ministrit / vendimi i ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore



**MODELI I DEKLARATËS PËR IDENTIFIKIMIN, VËRTETËSINË DHE ORIGJINËN**  
*[Ju lutemi lexoni me kujdes shënimet shpjeguese përpara se të plotësoni këtë dokument]*

1	<b>VENDI DHE DATA E LËSHIMIT</b> të kësaj deklarate
	<b>PËRSHKRIM</b>
	a) Lloji i objektit:
	b) Teknikat dhe materialet:
	c) Formati <input type="checkbox"/> HORIZONTAL; <input type="checkbox"/> VERTIKAL; <input type="checkbox"/> RRETH; <input type="checkbox"/> OVAL; <input type="checkbox"/> TË TJERË
	ç) Përmasat: lartësia: _____ cm; baza: _____ cm; thellësia: _____ cm; diametri: _____; pesha: _____ (kg)
2	d) Mbishkrime dhe shënja (nëse i aplikohet)
	dh) Përshkrim i lirë i çdo elementi tjetër identifikues dhe të tipareve dalluese relevante
	e) Titulli dhe tema (nëse i aplikohet)
3	<b>AUTORËSIA, ORIGJINA ARTISTIKE OSE PRODHUESE</b>
4	<b>ORIGJINA E PRONËSISË, PREJARDHJA</b>
5	<b>RIPRODHIM FOTOGRAFIK I BASHKËNGJITUR?</b> nëse PO, specifikoni numrin
6	<b>DOKUMENTET E BASHKËNGJITURA?</b> nëse PO, specifikoni titullin e secilit
7	<b>EMRI DHE ADRESA E TREGTARIT</b>
8	<b>NËNSHKRIMI DHE VULA PROFESIONALE</b>

**SHËNIMET SHPJEGUESE**

Ky model përfshin përmbajtjen informuese që duhet të përfshihet në deklaratën e lëshuar nga tregtari i pasurisë kulturore në rast të shitjes ose transmetimit në ndonjë formë tjetër. Origjinali i dokumentit, i nënshkruar si duhet dhe me vulën e tregtarit, i dorëzohet blerësit dhe i bashkëngjitet objektit kur natyra ose karakteristikat e tij e

lejojnë një gjë të tillë. Një kopje ruhet nga tregtari në dosjet e tij.

Nëse ndonjë informacion i rëndësishëm për seksionet e kërkuara në këtë model është përfshirë tashmë në një dokument tjetër në posedim të tregtarit, tregtari do ta përmendë atë dokument në këtë deklaratë dhe, gjithashtu, do t'ia bashkëngjisë kësaj deklarate. Për këtë qëllim,



mund të pranohen deklaratat për origjinalitetin ose prejardhjen të lëshuara nga muze me reputacion ndërkombëtar të respektuar nga bibliotekat publike, nga arkivat publike ose nga institucione të ngjashme të huaja.

Për një pasuri kulturore të përbërë nga disa pjesë të ndara, që tregtohen si një njësi (p.sh., një komplet çaji ose një komplet stolish), artikujt mund të dokumentohen individualisht ose mund të grupohen së bashku nën të njëjtën deklaratë; në rastin e fundit, duhet të përfshihet një listë me secilin artikull të grupit brenda përshkrimit me shkrim në deklaratë.

### **INFORMACIONI QË DUHET TË PËRFSHIHET NË DEKLARATË:**

1. VENDI DHE DATA E LËSHIMIT TË DEKLARATËS

2. PËRSHKRIMI

#### **a) Lloji i objektit**

Përshkrimi i shkurtër se çfarë është objekti në fjalë. Ky informacion mund të jepet me një fjalë të vetme.

Shembuj: ikonë, pikturë; kupë; libër; statujë; shpatë; vazë; unazë.

#### **b) Teknikat dhe materialet**

Këtu duhet të shënohet, me pak fjalë, se prej çfarë materiali është i përbërë një objekt (p.sh. druri, letre, qelqi etj.) dhe se si është bërë (p.sh. gdhendur, farkëtuar, qepur me dorë etj.).

Materialet mund të shprehën në terma të përgjithshëm, por kur është e mundur, një informacion më specifik është i dobishëm (p.sh. “pishë” në vend të “drurit”, ose “pergamene” në vend të “letrës”). Nëse ka pasiguri në lidhje me materialin e saktë, duhet të përdoret shprehjet e përgjithshme (p.sh. “metal”), dhe pastaj të përfshijë kualifikimet e mundshme (p.sh. “bakri ose bronzi”).

Për objektet e bëra me materiale të ndryshme ose përmes teknikave të shumta, duhet të përdoret një fjali e shkurtër gjithëpërfshirëse. Shembuj: “tas xhami i ndërtuar me dorë me bazë argjendi të stampuar me pruar”; “Maskë prej druri të gdhendur, gjysma e sipërme e kufizuar me pendë të palloit”; “Shpata prej çeliku me dorezë të veshur prej druri”.

#### **c) Format**

Për HORIZONTALIN ose VERTIKALIN, zgjidhni formatin sipas anës më të gjatë të veprës artistike.

Faqe | 5418

#### **ç) Dimensionet**

Mënyra se si mund të maten dimensionet ndryshon në varësi të llojit të objektit në fjalë. Në të gjitha rastet është e rëndësishme që të shënohet njësia matëse e përdorur (p.sh., centimetrat, gramët, kilogramët etj.) dhe dimensionet e matura (p.sh., lartësia, gjerësia etj.).

Matjet e sakta janë më të mirat, por nëse kjo nuk është e mundur, duhet të regjistrohet matja e përafërt, me një përmendje në regjistër se matja është e përafërt dhe jo e saktë.

#### **d) Mbishkrime dhe shenja, nëse i aplikohet**

Kjo mund të zëvendësohet ose të kompletohet nga një fotografim i detajeve përkatëse.

Kjo i referohet përmendjes së mbishkrimeve dhe shenjave përkatëse si numrat serikë, imazhet vizuale, numrat e inventarit, nënshkrimet ose mbishkrimet tekstuale. Duhet të theksohet se disa tipare, të tilla si pulla ose mbishkrime, mund të gjenden në anën e pasme të pikturës.

Duhet të theksohet se ku ndodhet shenja ose mbishkrimi i përmendur në objekt.

Teksti ose figurat duhet të përmenden saktësisht siç janë shkruar, edhe nëse ka gabime, të cilat mund të shënohen në regjistër duke përdorur shenjën [sic], ose duke thënë që ajo është e palexueshme në tërësi ose pjesërisht. Këto referenca duhet të përmenden në gjuhën e tyre origjinale.

#### **dh) Përshkrimi i lirë i çdo elementi tjetër identifikues përkatës dhe tiparet dalluese**

Kjo mund të zëvendësohet ose të kompletohet nga një fotografim i detajeve përkatëse.

Kjo i referohet çdo tipari unik që e veçon atë objekt nga artikujt e tjerë të një projektimi të ngjashëm. Kjo mund të përfshijë defekte fizike, shenja të riparimeve, defekte të prodhimit.

Karakteristikat e përmendura këtu duhet të jenë vetëm ato që mund të jenë të dukshme qartazi për syrin e thjeshtë. Shembujt mund të përfshijnë:

- për pikturat: çarje, riparime, parregullsi të kufizimeve, vrima, goditje dalluese të furçave, njolla;

- për dokumentet: gërvishtjet, vrimat, njollat, shenjat e ujërave, riparimet, gërvishtjet, llojet e skajeve, rrudhat, restaurimet, prerjet;





- për drurin: modelet e drithërave, modelet e sharrave, detajet e mobilierisë, veshjet sipërfaqësore, parregullsitë në detajet e zbukurimit;

- për metalet: defektet e derdhjes, të prerat, gropëzat, të gërvishtjet, saldimet e çrregullta;

- për tekstilet: lot, njolla, njolla ngjyrash, vrime, riparime, pjesë të konsumuara, ende të parregullt;

- për xhamet: gropat në xham, çarjet, flluskat, gërvishtjet, tekstura ose ngjyrat e parregullta në sipërfaqe, plasaritjet e lustruara, riparimet.

#### **e) Titulli dhe tema (nëse është e aplikueshme)**

Disa, por jo të gjitha objektet, do të kenë tituj. Ndonjëherë objekti nuk do të ketë titull zyrtar, por është bërë i njohur me një emër specifik. Një objekt gjithashtu mund të njihet me emra të ndryshëm në vende të ndryshme ose mund të ketë më shumë se një titull. Kur është e zbatueshme, titulli duhet të përmendet në gjuhën e origjinës së tij si dhe i përkthyer.

Kur nuk përfshihet në formulimin e titullit, “tema” përkrahur se çfarë synon të përfaqësojë objekti kulturor. Është e rëndësishme të përdorni shprehje që janë të qarta për të tjerët, duke përfshirë edhe ata që nuk janë specialistë, duke supozuar që individë të ndryshëm mund të përshkruajnë të njëjtin objekt në mënyra të ndryshme. “Tema” është më mirë të përmendet përmes fjalëve të thjeshta.

Shembuj: “Portret”; “Virgjëresha dhe fëmija”; “Figurë e një burri në këmbë”; “Skena e jashtme me qen”; “Peizazhi i detit me anije” etj.

#### **3. AUTORËSIA, ORIGJINA ARTISTIKE APO E PRODHIMIT**

Kjo pjesë ofron informacione që përcaktojnë origjinën e ekzistencës materiale të veprës artistike: identitetin e artistit; koha kur artisti e ka krijuar veprën artistike ose kur është prodhuar objekti antik; dhe, mundësisht, vendin ku u krijua. Ky informacion përcakton prejardhjen e objektit dhe origjinalitetin e tij.

Koha: në rastet kur nuk mund të përcaktohet një datë specifike, duhet të përdoret një interval kohor i datës së përafërt (p.sh., 1469–1473), periudha të përcaktuara në kohë (p.sh., fillimi otoman, pasbizantin), pjesë të shekullit (fundi i shekullit të katëmbëdhjetë, çereku i parë i shekullit të gjashtëmbëdhjetë), ose periudhat

kulturorë. Nëse një objekti kulturor i është ndryshuar koha në një datë të mëvonshme ose përbëhet nga pjesë përbërëse qartazi të bëra në epokë të ndryshme, të dy datat përkatëse duhet të shënohen.

Autorësia: Kur është e mundur, duhet të identifikohet krijuesi i vërtetë i objektit. Kjo mund të përfshijë një person ose disa të tillë, një komunitet, një kompani ose shkollë të dikujt. Duhet të theksohet se disa artistë mund të njihen me emra ose shqiptime të ndryshme: është e këshillueshme të përfshini variacione, nëse ato dihen. Nëse prodhuesi nuk është i qartë, mund të shtohen fjalë të pranueshme të tilla si “i atribuohet”.

#### **4. ORIGJINA E PRONËSISË, PREJARDHJA**

Kjo pjesë duhet të përmbajë një informacion narrativ të shkurtër, por të qartë, në lidhje me atë se çfarë dihet në lidhje me prejardhjen ligjore dhe historinë më të fundit të pronësisë së objektit (duke përfshirë datat e njohura dhe vendndodhjen e pronësisë së objektit, si dhe historikun e ekspozimit të tij, nëse ka).

Gjithashtu, kur është e mundur, duhet të tregohet ekzistenca e dokumenteve të prejardhjes të cilat vërtetojnë deklaratat të tilla.

#### **5. RIPRODHIMI FOTOGRAFIK**

Përfshini numrin e fotografive, nëse ka, që i bashkëngjiten deklaratës.

#### **6. DOKUMENTET E BASHKËNGJITURA**

Renditni dokumentet që konfirmojnë informacionin e shkruar në deklaratë (në pikat 3 ose 4) dhe të bashkëngjitura asaj.

#### **7. EMRI DHE ADRESA E TREGTISË**

#### **8. NËNSHKRIMI DHE VULA E TREGTARIT**

**URDHËR**

Nr. 35, datë 31.3.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHËRIN  
NR. 187, DATË 18.12.2020, “PËR  
MIRATIMIN E PROGRAMIT TË  
TRANSPARENCËS TË RISHIKUAR”, TË  
KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E  
INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE**

Në mbështetje të gremës “c”, të nenit 4 dhe neneve 5 e 6, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”,

**URDHËROJ:**

1. Në pikën 3, të urdhrit nr. 187, datë 18.12.2020, “Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, fjalët “... jo më vonë se data 31 mars 2021” ndryshohen në “... jo më vonë se data 30 qershor 2021”.

2. Ngarkohen autoritetet publike për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KOMISIONER  
Besnik Dervishi****URDHËR**

Nr. 36, datë 31.3.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHËRIN  
NR. 188, DATË 18.12.2020, “PËR  
MIRATIMIN E REGJISTRIT TË  
KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE TË  
RISHIKUAR”, TË KOMISIONERIT PËR  
TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE  
MBROJTJEN E TË DHËNAVE  
PERSONALE**

Në mbështetje të gremës “c”, të nenit 4 dhe neneve 5 e 6, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”,

**URDHËROJ:**

1. Në pikën 2, të urdhrit nr. 188, datë 18.12.2020, “Për miratimin e Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve të Rishikuar”, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, fjalët “... jo më vonë se data 31 mars 2021” ndryshohen në “... jo më vonë se data 30 qershor 2021”.

2. Ngarkohen autoritetet publike për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KOMISIONER  
Besnik Dervishi**



*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë  
të një procedure automatike nga një sistem elektronik  
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 80 lekë